

## GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

P. Nr.171/2009

Data: 12 mars 2012

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut të Gjilan, nëpërmjet trupit gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Vitor Hugo Pardal, si kryetar i trupit gjykues, gjykatëses së EULEX-it Rositza Buzova dhe gjykatësit vendor Rasim Rasimi si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Eriona Bitri Branding si procesmbajtës dhe Nexhmi Rexhepi si përkthyes, në lëndën penale kundër:

**KIMETE KRASNIQI**, emri i babait Fetah, emri i nënës Aleme Malaj (mbiemri i vajzërisë Gashi), e lindur me 24 prill 1980 në fshatin Negrovç, Drenas, femër, studente, e pamartuar, nuk ka fëmijë, shqiptare e Kosovës, banore e Drenasit, Kosovë,

E akuzuar me veprën penale të **vrasjes në tentativë** në kundërshtim me nenin 30, paragrafin 1 të Ligjit Penal të Kosovës, në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Ligjit të RSFJ (ende inkriminohet me nenin 146 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të KPK),

Pas seancave gjyqësore publike të mbajtura në prani të pandehurës Kimete Krasniqi dhe avokatit të saj mbrojtës Z. Destan Rukiqi, së bashku me prokurorin publik Z. Arben Kadriu nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut të Gjilanit dhe prokurores së EULEX-it znjsh. Elisa Moretti,

Pas fjalimit përmbyllës në seancën e 12 marsit 2012, të paraqitur nga prokurori Z. Arben Kadriu nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut të Gjiçanit dhe prokurores së EULEX-it znjsh. Elisa Moretti, për tërheqjen e akuzave kundër të pandehurës Kimete Krasniqi për veprën penale të përmendur më lart,

Në pajtim me nenin 389, paragrafi 1 dhe neni 52 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, lëshon të mëposhtmin:

### AKTGJYKIM

Akuzat penale kundër të pandehurës Kimete Krasniqi për veprën penale të vrasjes në tentativë në kundërshtim me nenin 30, paragrafin 1, të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Ligjit të RSFJ, ende inkriminohet me nenin 146 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) **REFUZOHEN** për shkak të tërheqjes së prokurorisë nga akuza në vijim:

*Në ditën në mes të 17 prillit 1998 dhe 16 majit 1998 e akuzuara Kimete Krasniqi, në bashkëpunim me persona të tjerë, të motivuar nga hakmarrja apo për përfitime personale dhe me paramendim dhe planifikim, tentuan të vrisnin Hamëz Hajrën. E akuzuara dhe bashkëkryerësit e saj planifikuan dhe ekzekutuan një pritë për viktimën afër kryqëzimit të rrugës nga Glogovci në Skenderaj me rrugën në Terstenik 2. E akuzuara Kimete Krasniqi, ka bërë aranzhime me viktimën, disa ditë para incidentit, për të që ta takojë atë me veturën e tij në kryqëzimin e rrugës së përmendur më lart. Viktima arriti në lokacion në kohën e caktuar dhe iu afrua të akuzuarës e cila po e priste në anën e rrugës. Gjersa ai po e bënte këtë një numër i "ushtarëve" të veshur në uniforma të UÇK-së dhe duke përdorur armë automatike dolën nga kaçubat dhe gjuajtën në veturë. Një numër i plumbave goditi veturën por viktima ia doli të vazhdojë vozitjen në drejtim të Glogovcit dhe iku pa dëmtime trupore.*

*Me këto veprime e akuzuara Kimete Krasniqi do të kishte kryer veprën penale të vrasjes në*

*tentativë në kundërshtim me nenin 30, paragrafin 1, të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Ligjit të RSEJ, (neni 146 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) siç është cilësuar juridikisht me Aktgjykimin AP-KZ 393/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 20 maj 2008.*

Pała e dëmtuar ka të drejtë të kërkoj kompensim të dëmeve në kontest civil sipas nenit 112, paragrafi 3, fjalja e parë e KPPK-së.

## ARSYETIM

### **Kompetenca e gjykatës**

Lënda bie brenda kompetencës territoriale dhe lëndore të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit tek e cila është dërguar për rigjykim nga Gjykata Supreme e Kosovës. Lënda më tutje bie brenda kompetencës së gjyqtarëve të EULEX —it në pajtim me nenin 15 të Ligjit mbi Juridiksionin (Ligji Nr. 03/L-053).

### **Historiati procedural**

E pandehura Kimete Krasniqi është gjykuar në mungesë dhe dënuar nga Gjykata e Qarkut të Gjilanit, gjykatësit ndërkombëtar të UNMIK-ut me aktgjykimin P.nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005, për veprën penale të: Vrasjes në tentativë të Hamez Hajrës të motivuar nga përfitimi personale, hakmarrje të pamëshirshme, motive të tjera themelore apo për hakmarrje duke vepruar në bashkëpunim , në kundërshtim me nenin 30(2) nënparagrafet 3 dhe 4 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 19 dhe 22 të LPRSEJ dhe Mbajtje të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 199 paragrafin 1 të

Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/17, dhe dënuar me një dënim unik prej 6 viteve burgim.

Me aktgjykimin AP-KZ 393/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës , të datës 20 maj 2008, akuza ishte ricilësuar si vrasje në tentativë, në kundërshtim me nenin 30, paragrafin 1, të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Ligjit të RSFJ, (ende i inkriminuar me nenin 146 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës KPK) dhe e pandehura Kimete Krasniqi ishte atëherë dënuar me një afat prej 5 viteve burgim.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në interes të pandehurës Kimete Krasniqi me 18 shtator 2008 ishte lejuar pjesërisht dhe lënda ishte kthyer në rigjykim në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit në akuzën e vrasjes së qëllimshme në tentativë. Kështu që, aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës ishin anuluar.

### **Ligji i aplikueshëm procedural**

Aktakuza në këtë lëndë ishte paraqitur në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit me 3 korrik 2002, para hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës , tani Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me 6 prill 2004.

Nenin 550 KPPK ofron "*Procedura penale në shkallë të parë në të cilën aktakuza, propozimakuza ose padia private është paraqitur para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi, por që nuk janë përfunduar deri në këtë datë, vazhdojnë në pajtim me dispozitat e ligjit të mëparshëm në fuqi deri:1) Në pushim të procedurës penale me aktvendim të formës së prerë ose 2) Kur aktgjykimi i marrë në shqyrtim gjyqësor merr formë të prerë*".

Procedural penale në rigjykimin e pjesërishëm të shkallës së parë ish-in paraqitur me Aktgjykimin AP-KZ 393/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 20 maj 2008. Për këto arsye dhe në pajtim me nenin 550, 2) KPPK, ligji i aplikueshëm procedural është Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

### **Konstatimet e gjykatës**

Kolegji prej tre gjyqtarëve është kompetent dhe ka kompetencë lëndore dhe territoriale për të gjykuar këtë lëndë, në pajtim me referencat specifike në këtë Gjykatë të vendosura nga Gjykata Supreme e Kosovës duke e dërguar lëndën për rigjykim të pjesërishëm, në lidhje me nenin 37.3 KPPK dhe me Ligjin e tanishëm të aplikueshëm mbi Juridiksionin, si dhe në bazë të regjistrit të tanishëm, i definuar nëpërmjet rregullave tani të aplikueshme lidhur me emërimin e gjykatësve vendorë për kolegje të përziera.

Në seancën gjyqësore kryesore të mbajtur me 12 mars 2012, Prokuroria Publike u tërhoq nga ndjekja kundër të pandehurës Kimete Krasniqit për veprën penale për të cilën ishte akuzuar.

Në këtë lëndë gjykata është e obliguar me dispozitën e nenit 389, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës e cila ofron: “Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur: 1) Paditësi është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor; 2) I dëmtuari tërhiqet nga propozimi; 3) I akuzuari për të njëjtën vepër është gjykuar me vendim të formës së prerë, është liruar nga akuza ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të forms së prerë ose 4) Ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti o falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale”.

Pasi që prokurori u tërhoq nga ndjekja, akuza penale në pritje e vrasjes në tentativë në kundërshtim me nenin 30, paragrafin 1, të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenet 19 dhe 22 të Ligjit të RSFJ, me nenin 146 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), e cilësuar ligjërisht me

Aktgjykimin AP-KZ 393/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 20 maj 2008, do të refuzohet pasi që neni 52 KPPK obligon Prokurorin të veprojë kështu.

Për arsyet e përmendura më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Mjeti juridik:** Ky aktgjykim mund të ankimohet para Gjykatës Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Gjiçanit brenda pesëmbëdhjetë ditë pas pranimit të saj sipas neni 398, paragrafi I i KPPK-së.

**GJILAN, 12 mars 2012**



Vitor Hugo Pardal

Kryetar i trupit gjykues

Rositza Buzova

Anëtar i trupit

Rasim Rasimi

Anëtar i trupit

Eriona Bitri Brading

Procesmbajtës

Nexhmi Rexhepi

Përkthyes